



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ROSKOVEC  
DREJTORIA EKONOMIKE

Nr. 3097 Prof.

PROJEKT-VENDIM

Nr. \_\_\_\_\_, date 23 / 04 / 2026

"PËR MIRATIM RISHPERNDARJE FONDESH NDERMJET PROGRAMEVE NË BUXHETIN E

BASHKISË ROSKOVEC PËR VITIN 2026"

Në mbështetje të ligjit 139/2015 "Per vetëqeverisjen vendore", neni 9 , pika 1.2 germa b , neni 23 dhe neni 54 pika dh , te ligjit 68/2017 "Per financat e veteqeverisjen vendore" neni 45 , të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor ne RSH" i ndryshuar neni 44 , paragrafi II , germa a , të udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomis nr.9 datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", vendimit të Këshillit të Bashkisë ", te VKB nr. 71 datë 24.12.2025 "Per miratimin e dokumentit perfundimtare te PBA 2026-2028 dhe i buxhetit te vitit 2026" si dhe materialeve të sjellë nga Drejtoritë përkatëse të Bashkisë;

-Ju paraqesim për diskutim e miratim;

- I. Të miratohet rishperndarja e fondeve ndermjet programeve per objektet e investime dhe shpenzimeve per operative & mirembajtje ne buxhetin e vitit 2026 si me poshte vijone:

**Shtohet:**

NR	GR	TIT	KAP	ART	EMERTIMI I PROGRAMIT BUXHETOR	EMERTIMI I OBJEKTIT/SHPENZI MIT	Njesia Shpenzuese	Vlera e plote e objektit /shpenzimit ' qe shtohet	2026	2027
1	00	04520	05	602	Rrjeti Rrugor Rural	Blerje materjale Mbulim kanali ,L=250 ml,Fshati Kuman	Bashkia Roskovec	1,692,797	1,692,797	0
1	00	04520	01	602	Rrjeti Rrugor Rural	Blerje materjale Mbulim kanali ,L=250 ml,Fshati Kuman	Bashkia Roskovec	1,087,620	1,087,620	0
					<b>SHUMA:</b>			<b>2,780,417</b>	<b>2,780,417</b>	<b>0</b>

**Pakesohet:**

NR	GR	TIT	KAP	ART	EMERTIMI I PROGRAMIT BUXHETOR	EMERTIMI I OBJEKTIT/SHPEN ZIMIT	Njesia Shpenzuese	Vlera e plote e objektit /shpenzimit qe pakesohet	2026	2027
	00	04520	05	231	Rrjeti Rrugor Rural	Mbulim kanali ,L=250 ml,Fshati Kuman	Bashkia Roskovec	2,780,417/ 2,780,417	1,692,797	1,087,620
	00	04520	01	231	Rrjeti Rrugor Rural	Mbikqyrje dhe kolaudim punimesh	Bashkia Roskovec	6,000,000/ 1,087,620	3,000,000/ 1,087,620	3,000,000
						<b>SHUMA:</b>			<b>2,780,417</b>	

II . Ngarkohet Administrata e Bashkise per zbatimin e ketij vendimi.

Konceptoi: O.Goga

Konfirmoi: D.Hoxha

Per Drejtorine Juridike dhe te Burimeve Njerezore : V. Zeqo

**KRYETAR**  
Majlinda BUFI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ROSKOVEC

Nr. 3097/1 prot.

Roskovec, më 23.04.2026

Lënda: Relacion shpjegues për projektvendimin **“PËR MIRATIMIN E RISHPËRNDARJE FONDESH NDËRMJET PROGRAMEVE NË BUXHETIN E BASHKISË ROSKOVEC PËR VITIN 2026”.**

**KËSHILLIT BASHKIAK**

**Roskovec**

**Të nderuar anëtar/anëtare të Këshillit Bashkiak!**

Në vijim të miratimit të projektit dhe preventivit për objektin : “Blerje materiali për mbulim kanali në fshatin Kuman me gjatësi 250ml” paraqitet ky relacion në lidhje me nevojën për saktësimin teknik të preventivit të punimeve.

Preventivi i miratuar fillimisht përfshin zëra punimesh të tipit “furnizim dhe vendosje”, të paraqitur në mënyrë të përmbledhur. Gjatë fazës së verifikimit teknik dhe zbërthimit të detajuar të analizave të çmimeve, është konstatuar se një pjesë e zërave nuk janë reflektuar në mënyrë të detajuar sipas strukturës standarde të manualit të çmimeve.

Për këtë arsye, është kryer një **zbërthim i detajuar i materialeve dhe proceseve të punës**, duke ndarë zërat në elementët përbërës (materiale, punë, transport, etj.), me qëllim paraqitjen më të qartë dhe transparente të preventivit, pasi do të realizohet nga punonjës të agjencisë të shërbimit publik.

Ky ndryshim përbën një **korrigjim teknik (lapsus)** në mënyrën e paraqitjes së preventivit dhe:

- **Nuk sjell asnjë ndryshim në vlerën totale të miratuar të projektit;**
- Nuk ndryshon volumet e punimeve;
- Nuk ndryshon natyrën apo qëllimin e investimit;
- Nuk ka asnjë efekt financiar shtesë për buxhetin e Bashkisë.

Rifformatimi i preventivit është bërë në përputhje me:

- Manualin e çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim (sistemi i integruar);
- Praktikat standarde të hartimit të preventivave;
- Kërkesat për transparencë dhe kontroll tekniko-financiar.

Ky saktësim synon:

- Rritjen e qartësisë në dokumentacionin teknik;

- Lehtësimin e zbatimit dhe supervizimit të punimeve;
- Përputhjen e plotë të preventivit me analizat teknike të çmimeve.

Duke qenë se kemi të bëjmë me një **ndryshim vetëm formal dhe teknik**, pa asnjë ndikim në fondin e miratuar, paraqitet i nevojshëm miratimi i këtij saktësimi nga Këshilli Bashkiak.

*Për drejtorinë e Planifikimit Dhe Zhvillimit Të Territorit, Mjedisit Dhe Pronës*

Drejtore

Eneida Hoxha

Miratohet :

Kryetari i Bashkisë

**Majlinda BUFI**